



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkeses për ri-shqyrtim të datës 08.04.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **NIKA Pro-Ing SH.P.K.** nga Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **NIKA Pro-Ing SH.P.K.** e datës 08.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 02.04.2024 të publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 02.04.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**Arsyetim**

Operatoret Ekonomik **NIKA Pro-Ing SH.P.K.** me datën 08.04.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

- Neni 1 i LPP-së**
- Neni 6 i LPP-së**
- Neni 7 i LPP-së**
- Neni 59 i LPP-së**
- Neni 60 i LPP-së**
- Neni 69 i LPP-së**
- Neni 72 i LPP-së**

### Pretendimet ankimore

Me datën 02.04.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e kemi rekomanduar për kontratë OE BM Group Sh.P.K.

Kemi bërë kërkesë për qasje, dhe na është lejuar qasja në OE e rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtun se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm

Arsyja e eliminimit tonë nuk qendron me pretendimin se:

#### ARSYETIM

Oferta juaj është e papërgjegjshme për arsyet si ne vijim:

- Në platformën elektronike kemi ofertuar me çmimin total 80,310,834.88 euro, ndërsa vlera e ofertës tuaj është 20,310,834.88 euro.  
Oferta juaj është e papërgjegjshme, bazuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 40.10, paragrafi b. i cili specifikon se:  
*b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.*
- Certifikata e regjistrimit të biznesit për liderin e grupit Anion Mep Contracting, është në gjuhën arabe, e pa pranueshme.

### Pretendimi I.

Nuk pajtohem me konstatimin e juaj pasi në nenin e LPP-se që jeni thirrur se ka mosperputhje mes cmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalin në Përshkrimin e cmimeve **nuk qendron** sepse edhe në raportin e hapjes kur është bërë shifet qarte se vlera pa TVSH është cmim i ofruar në rregull mirpo në llog e Tvsh është bërë një gabim, mirpo shifet qarte që nuk është e vertet se ka mos perputhje.

Pasi edhe ju e keni cekun se oferta jone është në vlerë prej 20,310,834.88€ njashtu në formularin e tenderit është e cekun :

## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-23-14371-5-1-1

Titulli i kontratës: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK"

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim.

#### 1 "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK"

3. Çmimi total i tenderit është:

80,310,834.88 EUR

Dhe në fjalë [shëno cmimin e tenderit në fjalë Euro]

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi	0.90	20310834.88
2	Garancioni i punimeve (min. 2 vite dhe maksimum 10 vite)	0.10	5 vite

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve,

Sig shifet ne formularin e tenderit te dorezuar eshte vlere e cekun me larte dhe raportin e hapjes eshte vlere pa tvsh ne rregull,

1.	Grup i Operatorëve Ekonomikë SUKA PrO- Ing SILPK: Pex & Co Group SLLP, Ka Saim Mag Contracting, Inc. Keshop Bldinet 10000 Feritaj	27.05.2014 - NPA	"Vendimi i Mësimsh- Qendra e Mësimsh Emergjente te QKUK"	PO	11213771/03	0010234300	01
----	---	------------------	---	----	-------------	------------	----

Ku shifet qarte se cmimi ne formularin e hapjes cmimi pa TVSH eshte cmimi ne rregull mirpo eshte bere gabim teknik ne llogaritja e TVSH-se.

Ky pretendimi eshte i bazuar, pasi oferta ne formularin e tenderit eshte me cmim pa TVSH ne rregull dhe nuk ka gabime, dhe perputhet me paramasen dhe parallogarin,

**Pretendimi 2.** Sa i perket qertifikatave te regjistrimit te biznesit, jane ne gjuhen arabe konform nenit 72, ju keni mundesi te kerkoni sqarime, pasi nuk eshte kriter per eliminim.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa pergjegjshem pasi qe nuk ka arrit te plotesoj kerkesat e DT.

**Pretendimi 3.** OE nuk ka karrit te permbushë kushtin

**Kërkesa 2.** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).

Pasi ka ofruar 2 deklarata nga banka mirpo ne te cilat shifet qarte se nuk i ploteson kerkesat e DT. Pasi i ka ofruar qe ka limit te aprovuar mirpo jo per kete projekt, te cilat limit munde te jene te shpenzuara. Dhe kerkesa eshte e qarte mjetet te gatshme apo qasje te pakushtezuara ne kredi per realizimin e kontrates.

**Pretendimi 4.** OE nuk ka karrit te permbushë kushtin

**Kërkesa 2.** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme-ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Millon Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Ne rast te konsorciumit, së paku 60% e punëve te përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Së paku njëri projekt te jetë spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin ne rast te grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.

Nuk pranohen objektet individuale, ambulanta, projekte rrugore, ura, ujësjellës, kanalizime, e te ngjashme.

Ka ofruar listen me kontrata te cilat shumica prej kontratave te ofruara jane me OE private te cilat nuk i permbushin kerkesat e DT, pasi nuk i kane te bashkangjitura qarkullimin bankare, situaciuinet dhe faturat, njashtu nuk kane pranime teknik. Kontrata te cilate jane te lidhura ne vitin 2018 deri 2020 nuk munde te llogariten si kontrata te realizuar pasi MSH ka qen dashte te

beje kerkes per sqarim per vitet 2021,2022,2023 te dihet qarkullimi i sakte bankare dhe i puneve te kryera qe te mirren per baze,

Me keto kontrata OE nuk ka arrit te plotesoj kushtin e kerkuar ne dosjen e tenderit.

**Prentendimi 5.** OE nuk ka karrit te permbushe kushtin pasi ka ofruar vetem 9 inxhinier jo 10 sa ka qen kerkesa. Nuk ka ofruar nje inxhinjer te elektros.

**Kërkesa 4. Staf i profesional – Inxhinierët**

Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me staf profesional te nevojshëm (min. 10 inxhinierë) për realizimin e projektit.



**"BM Group" Sh.p.k**  
**Lista e stafit me inxhinier që do jenë pjesë projekti**

NR.	Emri Mjekeri	Posta	Profesion	Ekspierenca vite
1	Ilir Moleq	Menaxher i projektit	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Civilim Konstruktiv	16
2	Halla Bajramaj	Menaxher i përditshmeve/operacionit	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Inxhinier Konstruktiv	11
3	Arben Masha	Inxhinier i Aplikuar	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Inxhinier Aplikativ	06
4	Sahil Hazazi	Inxhinier i Mbrojtjes Konstruktive	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Inxhinier Konstruktiv	05
5	Muhedin Merina	Inxhinier i Mbrojtjes Hidrologjike	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Inxhinier Hidrologjik	08
6	Florim Sytyzani	Inxhinier i Elektrikshkencës	inxhinier i diplomuar i Inxhinieritave Inxhinier Konstruktiv	02
7	Bektes Laku	Inxhinier i Makinave	inxhinier i Diplomuar i Makinave	07
8	Fatos Gashi	Geomet i Licencuar	Metier i diplomuar i Geometit	14
9	Mirvanet Harini	Likopen per zgjedhje shpirtore ne pune	Elektrik per zgjedhje shpirtore ne pune	5



Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njohimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parashih qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parashih që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Ju si autoritet kontraktues duhet të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

#### VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të OE Nika Proing Sh.P.K. & Pro & Co Group Sh.P.K. Anion Mep Contracting

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në

**RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:**

Ankesa juaj është administrativisht e pa pranueshme, duke marre parasysh se është adresuar nga NIKA PrO-Ing SH.P.K. si anëtar i konsorciumit, ndërkohe qe bazuar ne marrëveshjen për themelimin e grupit – Konsorciumit, Lider i grupit është kompania ANION MEP CONTRACTING, e autorizuar për nënshkrimin e te gjitha dokumenteve te tenderit dhe kontratës, shih nenin 2 te marrëveshjes:

### **Article 2**

The parties have agreed that the project bearer will be the leading partner ANION MEP CONTRACTING who is authorized to sign all documents related to the tender and the contract.

Sa i perket pretendimit qe e kundërshton arsyen e eliminimit rreth çmimit ne total te shenuar nga ana juaj ne Formular te tenderit dhe per certifikaten ne gjuhen arabe, nuk pajtohemi me keto pretendime dhe i konfirmojme arsyet e eliminimit sipas Njoftimit te dates 02.04.2024 se:

- Ne platformën elektronike keni ofertuar me çmimin total 80,310,834.88 euro, ndërsa vlera e ofertës tuaj është 20,310,834.88 euro.

Oferta juaj është e papërgjegjshme, bazuar ne Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 40.10, paragrafi b. i cili specifikon se:

***b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.***

- Certifikata e regjistrimit te biznesit për liderin e grupit Anion Mep Contracting, është ne gjuhen arabe, e pa pranueshme.

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar kerkesen per mbeshtetje bankare 4 milion euro, nuk pajtohemi me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka deshmuar mbeshtetje bankare te pa kushtezuar (limit te aprovuar 3.4 + 3 mil euro) ne total prej 6.4 milion euro, shih deshmite:

Theksojme se kompania BM Group shpk, me nr. identifikues 810839251 është klient i bankës tonë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Kemi diskutuar qëllimin e kompanisë ne fjale per mbeshtetje financiare sipas references “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”, nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

BM Group shpk, aktualisht eshte klient aktiv ne banken tone me nje limit te aprovuar prej EUR3,400,000.00 dhe banka eshte e hapur te perkrah cdo kerkesa te klientit bazuar ne kriteret dhe procedurat e brendshme te bankes per kreditim per projektin: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”, nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Deshirojme t’ju informojme se banka merr në konsideratë me interes të veçant cdo kerkesë financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë.

Theksojmë se Kompania “BM GROUP SHPK”, me numër identifikues 810839251, me pronar **Bedri Gilareva**, është klient i bankës tonë. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanisë ne fjale për mbeshtetje financiare sipas References: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1”**

” **BM GROUP SHPK**”, aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit te aprovuar prej **3,000,000 EUR** dhe banka është e hapur të përkrash çdo kërkesë te tij bazuar ne politikat e matjes dhe menaxhimit te riskut lidhur me meshtetjen financiare bazuar Referencen **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1”**

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar kriterin rreth puneve te kryera ne projekte te ngjashme- ndertim ose renovim i objekteve te larta, ne vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar Listen e projekteve ne total 30,901,003.51 euro, ku vetem me UNOPS i ka mbi 4.7 milion euro, mbi 6.2 milion euro ne Punimet ne Parkun Industrial ne Miradi, mbi 4.3 milion ne lagjen Marigona Hill, mbi 3.3 milion ne qendren Park Plaza Podujeve, mbi 1.3 milion euro ne parkingun e Prishtines, mbi 1.7 milion ne stadiumin e qytetit te Drenasit, etj.

Ju rikujtojme se permes Sqarimeve shtese te publikuara me daten 05.02.2024 eshte lehtesuar ky kriter, ku eshte specifikuar se "1. *Pranohen edhe investimet private (si investime ne ndertim te ndertesave afaristo banesore). Pranohen objektet individuale, pranohen ambulatat.*"

Sa i perket pretendimit per verifikim te transakcioneve bankare, kjo ka qene kjarte e specifikuar se "mund ti verifikoj" e jo "do ti verifikoj" - (*për investitor privat AK mund t'i verifikoj transakcionet financiare*).

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk i ka ofruar 10 inxhinier por vetem 9 inxhinier, nuk pajtohem me kete pretendim dhe njeherit ju rikujtojme se permes Sqarimeve shtese te publikuara me daten 05.02.2024 eshte lehtesuar ky kriter, ku eshte specifikuar se "*HIQET Tension i lartë dhe Tensioni i ulët. Këto dy kritere reduktohen ne vetëm një kriter Një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes, se paku 5 vite provojë pune profesionale.*"

Sqarim: Meqenëse nga dy inxh. e elektroteknikes kërkesat 4.6 dhe 4.7 janë reduktuar ne vetëm një kriter, numri total i inxhinierëve te kërkuar është ulur nga 10 ne 9 inxhinier.

Sa i perket pretendimit se nuk eshte zbatuar kriteri kryesor per dhenie te kontrates **tenderi i pergjegjshem me çmimin me te lire**, konsiderojme se ky pretendim eshte teresisht i gabuar duke marre parasysh se ne kete aktivitet Kriter per dhenie te kontrates ka qene **Oferta Ekonomikisht me e favorshme**: Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni i puneve te kryera 10%.

Gjate vleresimit te ketij aktiviteti AK e ka zbatuar nenin 59 te LPP-se, si dhe duke pasur parasysh Qellimin e aktivitetit per realizimin e projektit dhe per respektimin e nenit 1 te LPP-se duke e rekomanduar per kontrate OE sipas Kriterit te dhenies se kontrates Oferta Ekonomikisht me e favorshme, ku nese perllogariten Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni i puneve te kryera 7 vite 10%, atehere oferta e rekomanduar eshte fituese edhe sikur te gjitha ofertat te ishin te pergjegjshme.

Mangësitë e vogla ne ofertën e OE te rekomanduar i konsiderojmë si devijime te vogla, konform nenit 59.4 te LPP-se.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

#### **Vendimi i dorëzohet:**

1. NIKA PrO-Ing SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**